



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **21.01.2020**, me fillim në ora **10:15**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. **Afrim Dina**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi:

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes të gjithëve, i nderuar, nënkryetar i Komunës z. **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtor të drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, media, dhe ju gjithë të pranishëm!

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozojë :

REND DITE

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratim të Buxhetit për vitin 2020,**
3. **Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2019,**
4. **Shqyrtimi i Propozimit për tejkalimin e të hyrave vetanake për vitin 2019,**
5. **Shqyrtimi i implementimit të Planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm sipas Planit të veprimit për vitin 2019,**
6. **Raporti i punës së Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2019,**
7. **Plani i punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë komunale për vitin 2020,**
8. **Shqyrtimi i vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale me pronë private,**
9. **Shqyrtimi i Raportit të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2019,**
10. **Propozim për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pronave për ndërtimin e Sheshit Qendror të Qytetit në Rahovec,**
11. **Të ndryshme.**

Të nderuar anëtarë të KPF-së, para se me vënë rendin e ditës në votim, me kërkesë të drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër, ka ardhur si pikë emergjente dhe nëse ju pranoni që ta kemi si pikë shtesë, Shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pronave për ndërtimin e sheshit qendror të qytetit të Rahovecit.

Të nderuar anëtarë, a pajtoheni që ta kemi edhe këtë pikë shtesë?

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, anëtarët e KPF-së, drejtorët, përfaqësuesit e LMT-së, OSBE-së, të informimit dhe ju gjithë të pranishëm në sallë. Ne jemi të stërngarkuar me rendin e ditës pra ka mjaft pika të rendit të ditës mirëpo pasi që ju përshkruat që është emergjente dhe e domosdoshme, edhe pse kemi mjaft pika ne rend dite, ne e pranojmë edhe pse a ka mundësi që prej mbledhjes ne mbledhje me pas gjithmonë pika normal të rendit të ditës edhe me i trajtua dhe shqyrtua mirë që të kemi kohë me diskutua për të gjitha ato pika mirëpo pasi që ju thoni që është e emergjente dhe unë propozoj që të kalohet dhe të futet në rend dite. Faleminderit shumë!

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, përshëndetje për juve, nënkryetarin, kolegë këshilltarë, drejtorët dhe gjithë të pranishmit në sallë. Rreth kësaj pike shtesë që po e propozoni ju, tash edhe unë kam vërejtjen time sepse më të vërtet materiali është shume voluminoz për këtë mbledhje, nuk e di a do të jemi komod pastaj ta shqyrtojmë po nëse shumica pajtohen atëherë gjithçka në rregull por nëse nuk është urgjente unë kisha propozuar megjithatë ta shtyjme për një mbledhje tjetër. Te pika e tretë e rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit vjetor financiar për vitin 2019, materialin nuk e kemi marr as me shkrim apo e-mail adresë prandaj nuk e di se çka do të bëjmë me këtë pikë, në fakt nëse s'ka material, mundemi ta shtyjme për një mbledhje tjetër apo çka do të bëjmë.

Kryesuesi – Faleminderit z.Cena për kontributin tuaj për pikën shtesë, vërtete e kemi me urgjencë që ta trajtojmë, meqenëse na ka ardhur pak me vonesë prej së larti, kurse sa i përket pikës se tretë të raportit financiar kur të dalim te pika e tretë atëherë arsyetimin do ta bën drejtori për shkak se varet direkt prej Ministrisë se Financave edhe na duhet ta kemi si pikë të rendit të ditës. Faleminderit shumë për kontributin atëherë konsideroj se mund ta kemi edhe pikën shtesë ose e hedhim në votim. Tani e hedhim rendin e ditës me pikën shtesë. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës me pikën shtesë.

Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar – A ka dikush diçka rreth procesverbalit?

Fehmi Cena – Unë kam një vërejtje të vogël e në fakt është gabim teknik, në faqen 6-të është fjalimi im te pika e nëntë e në fakt e ka vendin te pika e tetë, së është diskutim për raportin kurse këtu ka qen diskutimi për shqyrtimin e propozim vendimit për vënien ne debat publik të planit lokal të veprimt, nuk është ky diskutim në këtë pikë por është në pikën e tetë, pra ky ndryshim duhet të behët. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit z. Cena, meqë nuk kemi tjetër të lajmëruar e hedhim në votim pikën e parë të rendit të ditës. Konstatoj se aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i propozim vendimit për miratim të Buxhetit për vitin 2020.

Afrim Limani – I nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, ju përfaqësues të mediave, te OSBE-së, përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë. Ndoshta duhet t'iu përkujtoj edhe njëherë se buxheti i komunës se Rahovecit për vitin 2020, është në total prej: 14,735,819 euro; Grandi i përgjithshëm: 5,843,393 euro; Këshilli i Hoçës së Madhe 24,904 euro; Grandi specifik i arsimit 5,820,978 euro; Grandi specifik i shëndetësisë 1,889,703 euro; do të thotë në total është grandit: 13,578,978 euro ndërsa të Hyrat vetanake janë: 1,156,000 euro, që të gjitha së bashku e bëjnë një buxhet prej: 14,735,819 euro. Nëse e bëjmë një krahasim në raport me vitin e kaluar atëherë kemi një rritje të grandit të përgjithshëm prej 612,097 euro pra Këshilli i Hoçës se Madhe një ndryshim do të thotë një rritje prej 1,410 euro pastaj grandit specifik i arsimit prej 440,000 euro, grandit specifik i shëndetësisë prej 101,463 euro, do të thotë në total ndryshimi nga viti i kaluar i grandit është 1,155,469 euro, mirëpo të hyrat vetanake kanë një zvogëlim në raport me vitin e kaluar prej 11 926 euro atëherë kur i zbresim edhe huamarrjen në

arsim dhe në shëndetësi të cilës këtë vit nuk kanë alokuar ministritë përkatëse, ndryshimi i buxhetit nga viti i kaluar është prej: 974 928 euro. Për dallim nga seanca e shtatorit kur e kemi diskutuar buxhetin, në këtë seancë ky dokument i ka disa ndryshime që konsideroj se janë rrënjësore, e para e kemi bërë një planifikim të saktë të të hyrave vetanake sipas kategorive ekonomike këtë gjë kemi mundur ta bëjmë sepse në fakt pasi u mbyll viti fiskal edhe e kemi shikuar gjendjen reale të inkasimit të të hyrave dhe kemi bërë një krahasim nga vitet e kaluara atëherë konsideroj se kemi bërë një planifikim të saktë të të hyrave vetanake gjithashtu kemi bërë edhe përshtatjen apo sistemimin nëpër kategori përkatëse, në kuadër të drejtorive që vazhdimisht i kemi pasur disa probleme të tilla. Si ndryshim tjetër në buxhetin e vitit 2020, referuar listës së projekteve kapitale, aty i kemi eliminuar të gjitha projektet kapitale të cilat në një farë forme kanë trajtën e keq klasifikimit pra keq klasifikim nuk kemi në listën e projekteve kapitale dhe nuk ekzistojnë. Atëherë e kam lënë një shumë të caktuar apo një limit të caktuar duke ditur që edhe ajo vlerë nuk e jep një opinion të keq të pasqyrave financiare sepse pasqyrat financiare kanë një limit të caktuar mbi 100 000 euro mirëpo megjithatë ne i kemi eliminuar pra i kemi larguar të gjitha keq klasifikimet edhe pse gjate vitit 2020 do të kemi problem me kategorinë e mallrave dhe shërbimeve dhe prishen balancat buxhetore edhe kuptohet në fund të vitit kemi me bartë një barrë ndoshta me të konsiderueshëm në raport me vitet tjera. Unë diçka tjetër me diskutua nuk kam mirëpo e lëmë përmes monitorit që të shikojm listën e projekteve kapitale dhe eventualisht nëse keni ju dikush ndonjë pyetje lirisht ju mund ta bëni.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për prezantimin, po urdhëroni z. Cena!

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, mendoj që kjo pikë e rendit të ditës është një nga pikat me të rëndësishme për mua se paku, ne e kemi shqyrtuar në buxhetin e vitit 2020 në kornizën afatmesme buxhetore në muajin shtator pikërisht me datën 26, e kemi diskutuar goxha gjatë dhe kemi pasur ato vërejtjet tona edhe plotësimet tona që i kemi kërkuar bazuar në vërejtjet tona, tash serish po e rishqyrtojmë për me kalua ky buxhet, unë e kam shikuar këtë, drejtori tha se janë bërë disa ndryshime e në fakt unë mundem me konstatua se i kanë bërë disa ndryshime por janë të vogla në krahasim me ato që kemi kërkuar ne. Unë po ju paraqes vërejtjet që kemi prezantuar atë ditë dhe ne është mirë sot si Komitet për Politikë dhe Financa me i cekë, për arsye se sigurisht se unë jam që kjo pikë me kalua për mbledhjen e ardhshme mirëpo është mirë me u bë ato ndryshime nëse mendojmë ne me kalua buxheti. Ne jemi për me kalua por ai duhet me kalua ashtu siç mendojmë ne, që ndryshimet e plotësojnë dhe e bëjnë më legjitim edhe me të plotë buxhetin për vitin 2020. Vërejtjet e tona kanë qenë qysh në fillim të përgatitja, pra të të hyrat kemi kërkuar disa sqarime dhe nuk janë bërë atë ditë, mirë është ne sot me i cek në mënyrë që drejtorja me punua ne atë drejtim ose me na dhënë sqarime sot ose së paku me u përgatit për mbledhjen e ardhshme. Te tabela e planifikimit të të hyrave vetanake komunale, te pjesa e urbanizmit se disa plotësime janë bërë dhe nuk dua t'i përmend ato, te urbanizmi p.sh. taksa për legalizim të objekteve në vitin 2019 kanë qenë të planifikuara 38,000 ndërsa për vitin 2020 janë 8,000, pse ky ndryshim, po ashtu edhe shfrytëzimi i pronës publike që për vitin 2019 kanë qenë të planifikuara 24,000 ndërsa për vitin 2020 asnjë cent do të thotë këto sqarime me na i dhanë, gjithashtu te shërbimet publike qiraja nga vendosja e objekteve tregtare për vitin 2019 kanë qenë të planifikuara 8,000 kurse për vitin 2020 kanë qenë të planifikuar 500 euro, do të thotë ka disa dallime të mëdha që ne kemi kërkuar sqarime. Tek inspekcioni, taksat tjera administrative 6,000 të planifikuara për vitin 2019 kurse vetëm 1000 për vitin 2020. Por vërejtjet tona me kryesore kanë qenë tek investimet kapitale, kemi pasur vërejtje se shumica e kodeve buxhetore që i keni prezantuar janë të prezantuar shpenzime të përgjithësuar por nuk i keni të specifikuar projektet p.sh. nëse thuhet ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit, ne kemi kërkuar të specifikohen cilat janë ato rrugë qoftë edhe në qytet nëse keni planifikuar ose trotuare duhet me ditë cilat janë ato rrugë me emër e mbiemër në mënyrë që ne me ditë se ku do të

bëhen ato shpenzime saktësisht që me mujtë me i përcjell ne si delegatë-kurse në mënyrë të përgjithësuar nuk është mirë, unë mendoj që drejtoritë janë për këtë arsye që me punua, me bo planin secila drejtori përkatëse për projektet që i ka me emër dhe mbiemër, cila do të jetë ajo rrugë, sa është e gjatë ajo rrugë, sa do të kushton ajo rrugë dhe në çfarë vendi do të bëhet. Tek keq klasifikimet drejtori që i ceku, unë kam vërejt që disa prej kategorive buxhetore janë përmirësuar mirëpo disa nuk janë përmirësuar edhe një numër goxha i madh dhe që janë të kushtueshme, kemi përsëri keq klasifikim, në investime kapitale përsëri janë të futura, për ato që ne kemi emëruar si mallra dhe shërbime dhe subvencione, ato vërejtje i keni pasur edhe nga zyra e auditorit qendror dhe përsëri keni mekanizmat bujqësorë, serrat, stallat dhe një mori kodesh që ne mendojmë që janë të përziera dhe është keq klasifikim, nuk e di tash drejtori që i karakterizon që nuk janë. Këto janë vërejtje dhe unë kisha dashtë që këto ndryshime mundësisht me u bë deri në mbledhjen e ardhshme në mënyrë që ne delegatet mos të kemi vërejtje kur të bëhet me kalua buxhetin. Faleminderit!

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, te tabela numër 2 në faqe 10, te burimi i të hyrave te planifikimi i të hyrave vetanake për periudhën 2019-2022 te drejtorja e Shërbimeve Publike kemi të hyra nga shitja e mbeturinave, këtu kërkoj sqarim se si realizohen këto të hyra, vlera e planifikuar për vitin 2019 ka qenë 140,000 euro ndërsa për vitet 2020-2022 ka rënie 32,000 euro, atëherë pse ka rënie kaq të madhe dhe sa i përket buxhetit për vitin 2020, ne këtu e kemi shqyrtuar me kohë në mbledhjen e shtatorit dhe kemi dalë me propozime konkrete mirëpo kryetari e tërhoqi këtë pikë nga rendi i ditës pasi që u shterën të gjitha diskutimet dhe nuk na dha mundësinë me votua buxhetin për këtë vit që jemi, e arsyet për këtë i dinë më se miri ai. Faleminderit!

Fahrie Lushi – I nderuari kryesues, të nderuar kolegë këshilltarë dhe gjithë të pranishmit. Po ashtu faqe 11 është edhe një keq klasifikim apo planifikim jo i mirë ku te Arsimit dhe Shkenca, participim për arsim jo formal në 2019 e kemi 15 000, ndërsa në vitin 2020 kemi 200 kurse 2021 është 250 e kështu që edhe ky është një planifikim jo i mirë dhe i papranueshëm nga ana jonë. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë desha të ndalem te këto projektet kapitale, te lista e projekteve kapitale, ku është kodi i ri, **Vazhdim i rregullimit dhe ristrukturimit të shtratit të lumit Rimnik...Rahovec...Fortesë..Celinë**. Unë edhe me herët e kam ngritë këtë çështje se lumi Rimnik se absolutisht nuk ka lidhje me Celinë për asgjë dhe as me territor kadastral, në qoftëse është mirë me ditë çka ndodhë, në qoftë se mendohet se ujërat prej Rimnikut nëpër Fortesë e Celinë me ardhë këtë pjesën këndeje, në të sqarohen apo në fakt çka është ky projekt i ri sepse Rimniku kalon nëpër Fortesë dhe shkon te Rugova atje derdhet dhe nuk ka lidhje absolutisht hiq me Celinë plus edhe arat nuk i kemi andej hiq as me kadastër dhe as pa kadastër dhe desha me ditë se çka në fakt është ky projekt. Ndërsa sa i përket listës se projekteve të investimeve kapitale tjera në përgjithësi dakordohem edhe unë plotësisht me parafolësit se vërtet të gjitha projektet janë të përgjithshme sepse ka edhe prej tyre që janë të veçanta dhe me te vërtet drejtoret e dinë këtë punë mjaft mirë që prej muajit maj kanë kohë të mjaftueshme me u marr me dal në terren dhe me bo matje mirëpo si duket se me shumë po ju konvenon kështu me projektet e përgjithshme dhe kjo nuk është e qartë as për neve dhe as për qytetarët edhe lejon hapësire me keqpërdorë apo me manipulua në favor të dikujt, kështu që e mira të mirës do të ishte që drejtoret për mbledhje të kuvendit të na vinë me specifikim të veçante dhe ne në kuvendë kur të votojmë të dimë se çfarë me të vërtet kemi votuar konkretisht të marrim shembull kodin 40809 në faqen e parë, **Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve vazhdim**, por këto rrugë dhe trotuare kanë edhe vendbanimet kanë emër edhe rrugët kanë emër edhe çdo gjë ka emër, po me duket se kemi kryer një procedurë në komunën tone, kemi bërë emërtimin e rrugëve nëpër fshatra dhe qytete kështu që vetëm po e marr si shembull se kështu i ke mbi dhjetëra kode që janë të këtij lloji, e për mos me e ngarkua mbledhjen unë thash që për mbledhjen të Kuvendit, drejtorët ta kenë specifikacionin për të gjitha këto dhe në mënyrë

të detajuar të na thuhet qartë p.sh. nëse fjala përmirësimi kanalizimeve ta marrim kodin 4832 **Përmirësimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit**, ku do të përmirësohen ato kanalizime në Çifllak, Celinë apo Optrushë pra në cilin vend do të përmirësohen dhe jo veç përmirësimi ose kemi edhe tjera si **Ndërtimi i trotuareve komuna e Rahovecit**, ju e shihni edhe vet të gjitha janë kode të përgjithshme, në qoftëse bazoheni në formulën se kështu ka qenë edhe përpara, unë pajtohem plotësisht se kështu ka qenë edhe përpara por na tash të shohim se apo shkojmë përpara apo mbrapa, pra unë jam për atë gjërat të ecin përpara dhe të mos kthehemi mbrapa në qoftëse kam gabua unë dje, të gaboni edhe ju sot kështu që është mirë me qenë këto kode të qarta për qytetarin edhe për të gjithë neve këtu, se në fakt në vitin 2020 ku dhe çka do të punohet, nuk do të lëshohem me tepër për këtë do të kontribuoj në mbledhjen e kuvendit. Faleminderit!

Dervish Çadraku – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju dhe kolegët e pranishëm këtu, shumë prej vërejtjeve që dhanë kolegët tanë janë të domosdoshme për tu thënë kështu që unë s'po dua me i përsërit disa prej atyre sepse janë po ato vërejtje apo shqetësime për të cilat ne, konkretisht unë, skam nevojë me i fol sepse i thanë parafolësit. Projektbuxheti edhe para kësaj here kur u ardhë, ne kemi pasur vërejtjet tona secili individualisht edhe bashkërisht në shumë pika mirëpo si duket kjo nuk ju ka bërë përshtypje sepse pak gjëra kanë ndryshua për të mos thënë fare kështu që është i njëjti projektbuxhete mua më bën përshtypje për mirë janë futur disa kode të reja edhe ka disa ndryshime ndoshta tepër shume të vogla të papërfillshme mirëpo megjithatë projektbuxheti nuk është shumë i balancuar, kur them kështu ka të bëjë me nevojat emergjente, të domosdoshme dhe nevojat që janë të dorës dytë dhe të tretë, këtu nuk i kemi të renditura sipas nevojave por tash cili është kriteri nuk e di por ky kriter të paktën mua nuk me duket shumë i qëlluar p.sh. kemi disa projekte të cilat duhen një shumë e mirë e parave dhe janë të domosdoshme por nuk kemi ndarë mjete për atë p.sh. vetëm për Zonën Ekonomike i kemi 10,000 euro, ajo Zonë Ekonomike është jetike për komunën tonë dhe bizneset tona dhe ne i kemi ndarë 10,000 euro ndërsa për tregun apo që po e quajmë Hardhfestin i kemi ndarë 40,000 euro d.m.th. cili është përfitimi këtu pra kriteri për të cilën jemi përcaktuar për këtë. Tregun ne e kemi ndërtuar dhe nuk nuk e di çka mundemi me shti 40,000 euro në atë treg sado që është i rëndësishëm dhe ka bërë një emër për Rahovecin, po a mundet të më tregoj dikush mua sidomos drejtori i Bujqësisë se sa kontrata janë lidhur duke shfrytëzuar këtë rast përmes fermerëve të komunës tonë edhe me afaristë që kanë ardhur prej vendeve tjera d.m.th. unë mendoj se është simbolike prandaj është një disbalancë ose kemi p.sh. Shtëpinë e pleqve që i kemi ndarë 10,000 euro që për mendimin tim nuk është ai që duhet me qenë, pastaj i kemi kabinetet dhe laboratorët që i kemi ndarë 10,000 euro që në fakt me mbi 30 shkolla, nuk e di se çka do të ndani me këtë shumë të parave dhe çka do të dërgoni nëpër ato shkolla, ju e dini se kemi të zbrazëta dhe disa herë e kam përsëritur, shkollat tona nuk kanë kabinete dhe laboratorë dhe tash nëse nuk punojmë me mjete konkretizuese që arsimtaret e din shumë mirë që është problem për tu mbajtur një mësim kualitativ gjate orës sepse ka ndryshuar edhe qasja edhe kriteret e ndryshme të cilat është problem me i urdhërua nxënësit me u bë interesant ora prandaj pa këto ne do ta kemi shumë problem edhe ne i kemi ndarë diku 10,000 euro, po aq e rëndësishme siç thanë parafolësit me të vërtete ne kemi problem me qytetarët sepse nuk dinë se çka t'iu thonë qytetarëve për këtë mandat apo për këtë vit buxhetor se ka kemi me ndërtua që të jemi të hapur t'iu tregojmë se kjo punë është kështu që me arsyetua edhe ne atë praninë tonë këtu ose mbrojtjen e votës tonë që na kane dhanë votën për t'iu mbrojt interesin e tyre d.m.th. kjo nuk ka ndodhur, unë i kam pasur vërejtjet e mia herën e kaluar të cilat nuk janë përfillur, kam kërkuar kanalizimin, kam kërkuar gropat septike, pra gjithsej komuna e Rahovecit ka mbi 60,000 banorë që veç Rahoveci ka mbi 17,000 banorë, nuk e di saktë se sa me të vërtetë është por ky numër shkon duke u zvogëluar për shkak të qeverisjes së mirë por me standardet evropiane e kemi doktorin këtu që brenda 24 orëve me standardet evropiane duhet me i pas rreth 40 litra ujë, për t'i pasur njeriu për amvisëri dhe aty përfshihet të gjitha, mundeni me nënkuptua, unë e kam llogaritur këtu 158 litra ujë dhe kam ardh në përfundim se veç Rahoveci për 24 ore i duhen 8848 litra

ujë dhe në qoftë se këto 8848 litra ujë shkojnë përmes kanalizimeve dhe derdhet në Drinin e Bardhë atëherë ato krijojnë ujëra të zeza e që në fakt veç Rahoveci i ka 2,686,000 litra ndërsa 8,448,000 litra i ka gjithë komuna. Kjo do të thotë se Rahoveci, Ratkoci dhe Krusha nuk kanë gropa septike e mos të flas për impiantet dhe vazhdimisht kam tërhequr vërejtje edhe unë e di se ato nuk pastrohen me ato por të paktën bëhet një lloje pastrimi me rënie të lirë d.m.th. këtë ju nuk e keni pasur parasysh dhe unë kërkojë që të merren parasysh këto vërejtje sepse në Kuvend ne duhet ta votojmë këtë por jo pa e vërtetuar pasi ky komitet është për këtë punë d.m.th. vjen projekti dhe ne japim vërejtjet tona dhe nëse nuk dëgjohemi ne atëherë nuk ke nevojë me sjellë këtu atë nëse nuk i merrni parasysh vërejtjet tona atëherë keni parasysh sepse ne jemi bashkautor të këtij projekti. Faleminderit!

Afrim Limani – Unë dua të filloj me radhë të ju përgjigjem ashtu siç i keni bërë pyetjet, Doktor i bëri 3 pyetje do të thotë kishte vërejtje në planifikimin e të hyrave, specifikim të projekteve edhe keq klasifikimi. Unë edhe në fillim thash që ndryshimi i kësaj qarkoreje në raport me atë të shtatorit është sepse unë konsideroj që e kemi bërë një planifikim real të hyrave edhe i kemi eliminuar disa kode ekonomike të cilat kanë qenë edhe në kuadër të dy drejtorive edhe konsideroj se ky planifikim është shume i saktë edhe kjo mbetet me vërtetua në fund të këtij viti në përqindje që besoj dhe shpresoj planifikimi përafërsisht mbi 90% ka me qenë i saktë sepse jemi marrë shumë me këtë punë edhe i kemi pasur të gjitha mostrat që mundemi me bo një planifikim real do të thotë ne e kemi pritur edhe realizimin e vitit fiskal të këtij viti dhe gjithmonë duke futur dhe duke bërë krahasimin me vitet e tjera atëherë unë konsideroj se ky është planifikim real, ju kishit vërejtje në kuadër të drejtorisë së urbanizmit taksa komunale për leje ndërtimi ka qenë ne vitin 2019 e planifikuar 35,000 dhe ne jemi shkuar në një planifikim real duke bërë edhe një krahasim nga vitet tjera jemi shkuar në 17,700 që konsideroj se ka me qenë e saktë në fund të vitit. Pastaj, taksa komunale për legalizimin e objekteve ka qenë 38,000 ndërsa tani 8,000 do të thotë aplikimi i kësaj hyrje ka filluar në muajin nëntor dhe realisht nuk kemi pasur më tepër se 500 euro inkasim të hyrave sepse njerëzit po ngurojnë me ardhë me aplikua edhe ne jemi duke shkuar përafërsisht në këtë vlerë dhe mund të ndodhë që ndoshta nuk mundemi t'ia qëllojmë këtu mirëpo ne konsiderojmë më tepër nuk do të ketë. Këtu e kemi edhe një të hyrë tjetër që nuk ishte vitin e kaluar, taksa leje mjedisore komunale 6,000 euro ndërsa shfrytëzimi i pronës publike që ka qenë e planifikuar për vitin 2019 prej 24,000 euro këtu ka qenë një gabim, se kjo e hyrë është edhe në kuadër të drejtorisë së Shërbimeve Publike pra këtë të hyrë e kemi edhe në shërbimet publike e që është e planifikuar prej 12,000 eurove. Pyetja tjetër ishte specifikim i projekteve, unë e kam sqaruar edhe herëve të tjera për shkak të sistemit PIB (Programi i investimeve publike), ne nuk mundemi me i futë të gjitha emërtimet në kuadër të atij sistemi sepse sistemi nuk na lejon mirëpo nuk do të thotë se ne nuk e kemi planin se ku do të bëhen këto investime p.sh. **Ndërtimi i rrugëve fushore**, drejtori e ka materialin pra përshkrimin komplet se ku do të investohet një rrugë pra në cilin fshat dhe në cilin vendbanim po ashtu njëjtë e ka edhe drejtori i shërbimeve publike p.sh. projekti **Ndërtimi i rrugëve në komunën e Rahovecit**, e ka materialin se ku do të ndërtohen ato rrugë dhe ju do ta keni materialin në e-mail pra në adresat e juaja sot apo nesër për secilin projekt pastaj janë edhe projektet e tjera **Ndërtimi i kanalizimeve në komunën e Rahovecit**, aty është e specifikuar se ku do të ndërtohen ato dhe ju do ta keni materialin në kopje fizike në duart tuaja mirëpo ne nuk mundemi me qitë në kuadër të sistemit PIB të investimeve kapitale sepse nuk na lejon sistemi, kjo është arsyeja edhe materialin do ta keni ju për secilin projekt. Te keq klasifikimet ishte pyetja tjetër doktor, unë konsideroj që në kuadër të investimeve kapitale nuk ka keq klasifikime edhe për këtë mundem me ta dhanë një garancë shumë të sigurtë edhe kur të bëhet auditimi i pasqyrave financiare do të shohim edhe opinionin e Auditorit Kombëtarë. Pyetja e Floridës ishte te planifikimi i të hyrave nga shitja e mbeturinave të cilat kanë një rënie drastike në raport me vitin e kaluar, këto janë të hyra tatimore të cilat limitet na i cakton Ministria

e Financave dhe kishim problem për ta zbritur këtë vlerë dhe duke ditur që ne nuk po mundemi me inkasua të hyra nga mbeturinat dhe jo vetëm ne por asnjë komunë në Republikën e Kosovës sepse ka shume mangësi tjera dhe mungon pako ligjore edhe shume tjera mirëpo ata po e qesin gjithmonë me shpresë se këtë vit do të rregullohet dhe kjo nuk po ndodhë asnjë vit dhe unë nuk shpresoj se dhe në vitin 2020 do të kemi të hyra nga mbeturinat. Edhe Fahria e kishte një pyetje njëjtë të hyrave të planifikimi i të hyrave në arsim do të thotë participimi për arsimin jo formal do të thotë një dallim shumë i madh 2019 me vitin 2020, pra i referohem fjalës time që thashë më herët se kemi bërë një planifikim shumë të saktë dhe real, që dy vite e kemi të planifikuar këtë kod dhe realisht ne nuk po inkasojmë të hyra. Nuk ka kërkesa që vinë për arsim jo formal bile këtë vit vetëm një ka ardhur me sa e di unë dhe deri sa nuk ka kërkesa atëherë përafërsisht një analizë të mirë që kemi bërë e kemi vendos 200 dhe nëse eventualisht aplikojnë 5 veta, ky planifikim përputhet me atë. Mësuesi Rasim ka pyetur për lumin Rimnik, për përmbajtjen e atij projekti pasi është drejtori Përparimi këtu ndoshta më mirë kish me na dhënë informata, të specifikimi i projekteve unë veç e thashë me përgjigjen e doktorit. Dervishi i ka bërë disa pyetje do të thotë buxheti i mangët në disa projekte, tash krejt ky buxhet që kemi po duhet të shpërndahet nga pak. Deri sa ishte fjala të Zona Ekonomike veç desha me thënë sepse aludova në këtë projekt, Zona Ekonomike jemi në fazën përfundimtare të licencimit të saj dhe besoj që brenda javës licencohet dhe në momentin kur licencohet zona atëherë jo vetëm që do të rritet buxheti i komunës tonë por do të ketë edhe investime nga ministritë e linjës dhe me një buxhet të madh, këtu nuk do të ngurrojnë me investua edhe donatorët, besoj që për vitin 2021 vlera do shkon mbi 400 euro në kuadër të këtij projekti. Besoj që ju kam përgjigjur pyetjeve dhe nëse i kam ngelur ndonjërin borxh, i kërkoj falje por jam edhe këtu do të mundem me ju përgjigj.

Perparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtare të Komitetit për Politike dhe Financa, të nderuar monitorues dhe ju gjithë të pranishëm. Megjithëse është projekti i drejtorisë së Urbanizmit ndoshta më mirë do ta sqaronte drejtori kur të vjen në Kuvend mirëpo do të flas për disa çështje që u ngritën këtu, është fjala për 3 kode të shërbimeve publike, **Meremetimi i rrugëve dhe trotuareve, Ndërtimi i rrugëve lokale dhe Ndërtimi i trotuareve në komunën e Rahovecit**. Unë do të mbledhë të gjitha shënimet edhe do të specifikoj për të gjitha rrugët dhe gjitha planifikimet që janë planifikuar për vitin 2020 dhe do të jap si material fizik pra si aneks të gjithë anëtarëve të kuvendit ku janë të planifikuara për të 3 kodet. Në shërbimet publike 80% e buxhetit është vazhdimësi e projekteve të kaluara mirëpo janë këto 3 kode që kërkojnë sqarime dhe unë do të jem i gatshëm për me ju dhënë sqarime për të gjitha. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shume drejtor, besoj që drejtorët i dhanë disa sqarime apo të dhëna të përgjithshme, po urdhëroni z.Cena!

Fehmi Cena – Faleminderit, po drejtorët i dhanë disa sqarime vërtet edhe kjo është mirë tash rreth specifikimit se atë ne e marrim si problem serioz, ata premtojnë se ka projekte që janë të specifikuara atëherë le ta kemi materialin për mbledhjen e ardhshme për secilin dhe jo vetëm në drejtorinë e shërbimeve publike por ka edhe ne drejtori tjera edhe le të cekin saktësisht projektet po ashtu le të cekin projektin në vazhdim është ky dhe projekti i ri është ky sepse ndryshe nuk mund t'i përcjellim ato, nëse është kjo nuk do të ketë problem por nëse nuk bëhet atëherë ka me pas problem përndryshe nëse është drejtori për financa ai po thotë se keq klasifikimi, se nuk ka keq klasifikim dhe ne i kemi cekur disa dhe prapë janë këtu p.sh. **Mekanizmi bujqësor për bujqit, është kodi 47832, faqe 2, të Planifikimi i kapitaleve-përkrhja e fermerëve në komunën e Rahovecit me mekanizëm bujqësor vazhdim**, na mendojmë se kjo është keq klasifikim pra është subvencion. Ne faqen tjetër **kodi 40839 Hartimi i projekteve të ndryshme** nuk është kapitale, këto janë mallra dhe shërbime, pastaj **Hartimi i planit lokal të veprimit në mjedis 48025**, krejt hartimet çka janë nuk janë kapitale, në qoftë se drejtorja

mendon këtë pjesë duhet të ju bashkëngjite projektit kapital që do të kushtojë kur do të fillon, le të jetë pjesë e saj aty le të ndahet buxheti ose t'i bashkëngjitet e jo me figuruar këtu, le ti bashkëngjitet projektit konkret që ata mendojnë me i precizua, ekziston kjo mundësi por me ekzistua këtu si i veçantë kodi p.sh. për hartim atëherë nuk është kapitale, dhe ne kemi të drejtë se nuk është kapitale dhe është mallra dhe shërbime. Faleminderit!

Dervish Çadraku- Unë e di që kërkesa jonë ka mjaft punë për drejtorët edhe pse nuk kanë punë tjetër, megjithatë është detyrë e tyre dhe për këtë punë paguhen, unë e kisha dhënë një propozime nëse e pranojnë këta zotëritë e tjerë, që materialin që po e kërkojmë ne, me specifikacione të mos ju shpërndahet të gjithëve anëtarëve të kuvendit por vetëm shefave të grupeve sepse ne kemi me marrë qëndrime për këtë punë p.sh. unë e kam për të gjitha ato kërkesat tona dhe për këto çka i kemi ne dhe bisedojmë për të gjitha këto çështje edhe të marrim qëndrime për punën e buxhetit dhe nëse ju duket se ka me ardh shumë material sepse secila drejtori ka shumë material atëherë nuk ka nevojë për të gjithë anëtarët por vetëm për grupet, ky është propozimi im dhe është me lehtë për juve edhe ne mundemi me krye punën. Faleminderit!

Kryesuesi - Faleminderit shume z. Çadraku, kërkesa juaj rreth kursimit të materialit që të'iu dërgohet vetëm shefave të gupeve megjithatë ne po punojmë që t'iu dërgohet të gjithëve, po urdhëroni drejtor Limani!

Afrim Limani – Doktor, unë u zotova te keq klasifikimet se nuk do të ketë edhe goxha mirë e kam menduar kur e kam thënë këtë fjalë se nuk është e lehtë me than para gjithë juve anëtarët e Kuvendit dhe do të vjen momenti që do jem i gatshëm të ballafaqohem me juve nëse nuk del kjo, edhe njëherë po e përsëris se keq klasifikime nuk ka sepse e kam analizuar shumë mirë këtë punë. Te hartimi i projekteve edhe unë e kam menduar njëjtë edhe jam konsultuar për këtë edhe vetë emërtimi po tregon se është në kuadër të mallrave dhe shërbimeve mirëpo me ligj është e specifikuar, do të thotë hartimi i projekteve është investim kapital, po supozojmë se gjate hartimit të një projekti kostoja e atij projekti, pra hartimit të projektit ka kushtuar 500 euro, vlera e atij projekti ideor në letër rrit koston e projektit të implementuar pra këtu është esenca, atëherë nuk mundet me u trajtua si keqklasifikim si mallra dhe shërbime por është në investim kapital sepse drejtpërdrejtë ajo vlerë e hartimit të projekteve e rrit vlerën e atij projekti kapital pra këtu është esenca.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor, atëherë meqë nuk kemi pyetje tjera për piken e dytë të rendit të ditës, konstatoj se kalon për kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Raportit vjetor financiar për vitin 2019. -

Afrim Limani – Unë kërkoj falje që nuk kam mundur t'iu dorëzojë juve raportin financiar vjetor si kopje fizike apo të paktën me e-mail. Të them të drejtën ne e kemi qitë si pikë të rendit të ditës me mundësi edhe me shpresë se deri me këtë datë do ta kemi një barazim nga Ministria e Financave mirëpo këtë punë deri dje pasdite e kemi bërë dhe hezitova me ju dërgua me e-mail pasi nuk e pash të arsyeshme një natë para mbledhjes me ju dërguar, pra raportin sot e kam gati dhe për këtë kërkoj shumë falje, e kemi qitë në KPF me shpresë se do të vjen si material. Zakonisht raportet e fund vitit që janë fiskale kanë një procedurë më të gjatë të përpunimit pra të përgatitjes dhe për këtë arsye ka shkuar deri në këtë datë ndërsa raportet tjera periodike tre mujore, gjashtë mujore dhe nëntë mujore nuk besoj që do të kemi probleme me ato dhe materialin do ta keni në afat, pra edhe njëherë kërkoj shumë falje.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë drejtorit i kisha thënë se më mirë kish me qenë me na dërguar dje se sa hiq edhe të paktën bile gjatë natës kish pas mundësi me shfletuar dhe e kishim analizuar, kishim mundur me fol diçka për të por në mungesë të materialit ju mundeni tani lirisht të uleni sepse nuk kemi edhe për çfarë të flasim. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Fazliu, konstatojmë se kalon për Kuvend pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozimit për tejkalimin e të hyrave vetanake për vitin 2019.

Afrim Limani – Faleminderit kryesues, neni 30.4 të ligjit të Financave Publike dhe përgjegjësi e përcakton qartë se kur kemi tejkalim të hyrave vetanake atëherë duhet paraprakisht ta kemi edhe vendimin e kuvendit komunal në menyrë që kjo tepriçë e mjeteve të shkojnë në kuadër të mbulimit të projekteve të caktuar, kështu që ne si dokument e kemi përgatitur dhe ju kemi dërguar me kohë edhe pse kemi tani një ndryshim për kuvend. Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Rahovecit për vitin 2019 kanë qenë 1,168,768 euro ndërsa realizimi i të hyrave ka qenë 1,286,107 euro pra me një ndryshim prej 17,399.59 euro mirëpo në kohën kur e kam dërguar materialin për KPF në fakt gjobat e trafikut ishin akoma të pa alokuara sepse ato zakonisht vinë pas datës 10-të, ndërkohë ato janë alokuar dhe ne e kemi bërë shpërndarjen dhe janë kanë afërsisht 21,000 euro, tash tejkalimi 130,000 afërsisht do të thotë materialin do ta keni për Kuvend atëherë këto mjete ne i kemi paraparë të shpërndajmë në kuadër të këtyre programeve apo të këtyre kodeve të investimeve kapitale që ne i kemi përzgjedhur si më të nevojshme dhe më urgjente edhe duke ditur që kemi edhe obligime financiare ndaj këtyre operatoreve. Këto janë tre programe do të thotë e kemi bërë përzgjedhjen te: **Ngrohja qendrore për shkollat e komunës së Rahovecit** sepse kemi obligim edhe mjete të planifikuara për vitin 2019 kemi të pakta pastaj është **Ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në komunën e Rahovecit** që edhe këtu kemi obligime të paktën me 20,000 mundemi me zbutë situatën gjithashtu edhe ne kuadër të shëndetësisë kemi obligime që i kemi shpërndajë në **Ndërtimi i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Emergjente** në shumën prej 61 339 euro.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor, a ka dikush diçka rreth pikës se katërt të rendit të ditës, atëherë nëse nuk ka, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë:

5. Shqyrtimi i implementimit të planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm sipas planit të veprimit për vitin 2019.

Afrim Limani – Për këtë pikë të rendit të ditës, unë nuk e di pse duhet me dal në Kuvend, kam biseduar me Kryesuesin dhe më ka sqaruar mirëpo sido që të jetë edhe kjo është pozitive të paktën të keni njohuri edhe te jeni të informuar në zbatimin e rekomandimeve të Auditorit Kombëtar. Auditimi, pasqyrat financiarë të komunës së Rahovecit për vitin 2019, Auditori Kombëtar ka dalë me 21 rekomandime, prej të cilave nganjëherë një rekomandim është më i fuqishëm se dhjetë të tjera edhe pse janë shumë ato janë më të lehta të zbatuara, pra ka dalë me 21 rekomandime, prej të cilave ne si drejtori e Financave bashke me ekzekutivin i kemi mbajtur disa takime pra mbledhje me theks të veçantë për angazhimin në implementimin e këtyre rekomandimeve dhe ne konsiderojmë prej 21 rekomandimeve, 14 janë zbatuara, 5 pjesërisht të zbatuara dhe 2 të pazbatuara pasi mundësitë tona janë të pamundshme me reflektua te moszbatimi i këtyre 2 rekomandimeve sepse kjo ka të bëjë me punëtoret pra stafin e emergjencave të cilët janë nën menaxhimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ne punët tona, shkresat tona ju kemi dërguar dhe atë çka duhet bërë nga ana jonë, tash të shohim. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor, rreth asaj që tha si pikë të rendit të ditës ne e kemi në planin e punës të Kuvendit me të cilin e kemi hartuar atë plan dhe kemi qenë së bashku me anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorët, anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe për këtë arsye e kemi në rend të ditës.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, në fakte këto rekomandime i kemi parë edhe me herët dhe e kemi shqyrtuar raportin e Auditorit Qendror që kanë qenë 21, tash drejtori po thotë se janë zbatuar shumica veçse kemi raportin përpara, edhe pse disa nuk i kemi të qarta edhe pse thuhet janë zbatuar p.sh. po ndalemi tek rekomandimi numër 7, marrëveshja për shërbime të veçanta, aty ka pasur vërejtje se janë punësuar mbi 9 punëtorë edhe kanë pasur kontratë mbi vepër që ka zgjatur me shume se 6 muaj e që sipas rregullës nuk

duhet me zgjatë, e këtu po thotë është zbatuar, pyetja është a është zbatuar sipas kodit të qeverise lokale apo sipas rekomandimit që ata e kanë dhënë sepse kjo është krye dhe faktikisht është shkelur njëherë, janë punësuar njerëzit dhe kanë punuar me shume se 6 muaj apo ndoshta kjo do të vlejë për vitin 2020, pra janë disa sqarime të cilat ne po i shohim por shpresojmë që ato në të ardhmen të zbatohen tërësisht, disa janë pjesërisht edhe ato të kryhen plotësisht në mënyrë që kur të bëhet auditimi për vitin 2018 që të mos kemi shume vërejtje, së me siguri se do të këtë vërejtje por ato të mos jenë shumë serioze që shkelin rregullat ligjore apo tjera që nuk do të duheshin të ndodhin apo të përsëriten që nuk duhet të përsëriten të mund të përmirësohen. Faleminderit!

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, me gjerësisht do të diskutojmë në mbledhje të Kuvendit për këtë pikë të rendit të ditës por unë pajtohem plotësisht me parafolësin që rekomandimet këtu janë zbatuara, mirëpo ato shkelje që kanë ndodhur gjatë atij viti për të gjitha këto rekomandime, shtrohet pyetja çka u bë me ato rekomandime, si janë zbatuar p.sh. unë po shkoj te çështja e lëshimet aritmetikore në para masën e kontraktuar sepse kemi edhe shume gabime gjuhësore, ku thotë se në 3 raste komuna kishte nënshkruar kontratat për punë ku ofertuesit kishin bërë gabime aritmetikore në paramasën në të cilën kishin ofertuar. Unë po ju tregoj se këto lëshimet aritmetike ndonjëherë bëhen edhe me qëllim sepse janë si trikë i atyre që aplikojnë për një tender pasi me qëllim e kanë gabimin në shifra për me dalë tenderi që është më i lirë pasi e merr tenderin e kryen punën edhe pastaj ti konstatoju sa të duash se kanë qenë gabime aritmetike apo të themi është zbatuar apo nuk është zbatuar. Pra po e përmendi edhe unë një rast e që ka plot ose të zëmë te stoqet e naftës aty ku kanë qenë 3000 litra e tani në fund të vitit përnjëherë u lidhë kontrata për kaq litra, aty nuk mundesh me thënë që është e përmirësuar apo është zbatuar pra nafta ka qenë dhe është blerë naftë tjetër menjëherë në fund të vitit d.m.th. janë disa gjëra që në të ardhmen nuk do t'i përsërisim sepse nuk është zbatuar asgjë por këto gabime nuk do t'i bëjmë në të ardhmen. Faleminderit!

Fahrie Lushi – Edhe unë kam te çështja C2 dosjet të pa azhurnuara të personelit, normal edhe ky llogaritet si i zbatuar madje, si është i zbatuar ky rekomandim përderisa auditori i ka gjetur ato shkelje ku dosjet janë të pa azhurnuara në atë vit, përkatësisht me këtë rekomandim bie ndesh drejtoria apo gjithkush tjetër që thotë se ky rekomandim është i zbatuar. Faleminderit!

Afrim Limani – Unë kam një sqarim të shkurtë tek marrëveshja për shërbime të veçanta do të thotë auditori këtu a bazua në dy të gjetura pra dy kritere, e para ka munguar menaxheri i udhëheqjes pra stafi dhe e dyta kanë munguar raportet pra raportet e punës se një punëtori. Pra te këto dy të gjetura ka aluduar auditori kombëtar dhe ne e kemi eliminuar këtë, e kemi përzgjedh menaxherin dhe raportet edhe tash për çdo muaj i kemi raportet mujore të secilit punëtor. Mësuesi Rasim ka pyetur në lidhje te nafta, aty u ndërlidh me tepër si bartje nga viti paraprak me vitin e ardhshëm, pasi nuk e kemi ditur se sa rezerva janë sepse ka munguar aparati i cili e matë sasinë në kuadër të rezervuarit se sa litra janë edhe në fakte unë kam thënë edhe me herët një punë shumë voluminoze e kanë bërë auditorët saqë kanë dalë edhe ne teren edhe kanë bërë verifikim fizik të mostrës që s'ka ndodhur asnjëherë, pra nuk ka pasur tregues që e matë sasinë e naftës edhe sa litra janë në rezervuar që është bartur nga viti aktual në vitin e ardhshëm, pra nuk kemi pasur tregues që e matim, e ato i kemi ble edhe e konsiderojmë se është e zbatuar sikurse te shërbimet e veçanta edhe ato janë të zbatuara, edhe goxha problem e kemi pasur për të gjetur në treg. Fahria tha te dosjet e pa azhurnuara të pakompletuara kanë qenë, diku 4 apo 5 mostra ju ka munguar nga një dokument po supozojmë në njërën ka munguar certifikata e lindjes, përvoja e punës, diploma edhe ato qysh ne fillim pra janar 2019 i kemi kompletuar gjitha dosjet pra në gjuhën e Auditorit emërtohen si të zbatuara dhe pazbatuara.

Dervish Çadraku – Nuk e kuptova problemin e punëtorëve të emergjencës, cila ishte përgjigja që thatë ju statuti i tyre, a janë me komunë apo me ministri, po me intereson cila ishte përgjigja pasi nuk e mora vesh

mirë pasi keni bërë një shkresë dhe a keni marrë përgjigjen pra ende nuk është e rregulluar kjo punë për ta ditur pozicionin e tyre.

Afrim Limani – Ne kemi bërë veprimin tonë, mirëpo që nuk janë përgjigjur ajo është çështje e tyre do të thotë auditori këtu një të gjetur pra gjithë punëtorët e zjarrfikësve janë nën ombrellën e Ministrisë për Punë të Brendshme dhe vetëm pagat që i marrin te na, pra kjo është paradoks mirëpo ne seminarët pra takimet që i kam mbajtur unë me Ministrinë e Financave nga viti 2021, zjarrfikëset do të kalojnë në kompetenca të plota në kuadër të Ministrisë të Punëve të Brendshme.

Kryesuesi - Faleminderit shumë drejtor, atëherë nëse nuk ka tjerë të lajmëruar konstatoj se kalon për Kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2019.

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politike dhe Financa, drejtorë dhe gjithë ju të pranishëm. Pra është Raporti vjetor i punës për vitin 2019, raporti është shumë voluminoz mirëpo ne jemi përpjekur me qenë më i shkurtër këtu e dhe e kemi lekturuar. Unë vetëm po ju paraqes këtu synimet politike në qeverisje, aktivitetet të cilat ishin më të rëndësishme, prioritetet kryesore gjithashtu këto prioritetet vazhdojnë me qenë të rëndësishme edhe për këtë vit dhe vitet e ardhshme pastaj në këtë raport janë të sqaruara punët të cilat janë p.sh. në Zyrën e kryetarit pastaj Njësinë e Auditimit të Brendshëm, Zyrën Ligjore, Avokaturën, Njësinë e Personelit, Zyrën Komunale për Kthim dhe Komunitete në mënyrë tabelore aktivitetet të cilat i kanë zhvilluar ata pastaj i kemi edhe raportet e drejtorëve që janë të ndara në katër periudha që përfshihen tre mujori i parë janar-shkurt-mars, pastaj tre mujori i dytë prill-maj-qershor, tremujori i tretë korrik-gusht-shtator dhe tremujori i katërt tetor-nëntor dhe dhjetor. Unë nuk e kisha zgjatur me tepër në qofte se ju keni pastaj për të diskutuar, ne jemi këtu dhe gjithnjë jemi në shërbim dhe përmirësim të shërbimeve sa me të mira për qytetaret e komunës tonë.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues, thuhet që gjatë kësaj periudhe janë ndarë gjithsej 95 bursa për studentët e komunës së Rahovecit të cilët studiojnë në universitet publike në vende ndërsa vitin e kaluar kanë qenë 63 studente që kanë përfutur bursa, tash po me vjen shumë mirë që janë rritë numri i studenteve që kanë përfutur bursa por kërkoj sqarime për me ditë se sa ka qenë vlera e bursës vitin e kaluar dhe sa është tash, që ka ndryshuar ky numër për me ditë vlerën totale të bursës. Faleminderit!

Fehmi Cena – Unë mendoj se është një raport kështu i përgjithësuar edhe është voluminoz, ne do të kemi mjaftë punë për ta shqyrtuar nëse shqyrtojmë seriozisht, se këtu janë të përfshira të gjitha drejtoritë, prandaj edhe raporti është shumë voluminoz. E kam vërejtur se është prezantuar në formë të planifikimit tre mujorë edhe raporti, secila drejtori e ka prezantuar në periudhën tre mujore, mendoj që nuk është përmbledhje por më shumë është mbledhje, dhe është dashtë me qenë vjetor në mënyrë që me qenë më i shkurtër, po ashtu janë prezantuar edhe format tabelore në formë të pikave disa drejtori kur është deshtë shumica prej tyre në forme pikave dhe tabelore është shumë më i qartë raporti. Pastaj për mendimin tim raporti duhet me pas ato pjesë të planifikimit në mënyrë që të shikohet se jo çdo pjesë është realizuar, unë nuk besoj që secila drejtori që ka planifikuar dhe ka realizuar pra raporti duhet të përfshijë edhe pjesën që nuk është realizuar edhe jepet një arsye pse nuk është realizuar, a ka qenë pjesë e buxhetit apo e resurseve humane megjithëse njerëz jemi edhe e dimë se diçka mund të tejkalohet por është vështirë pastaj aty me u ditë, disi është një mbledhje e aktiviteteve më shumë, që konkretisht në ndalemi të Zyra për Barazi Gjinore, pjesa që është planifikuar kryesisht e kemi aty dhe nuk ka diçka konkrete p.sh. është përcjellë, është punuar, është respektuar ligji për barazi gjinore etj. por nuk ka të dhëna se a është respektuar apo nuk është respektuar p.sh. sa punësime janë kryer brenda institucioneve publike brenda vitit 2019, sa janë femra prej tyre që janë punësuar në pozita vendimmarrëse. Këto duhet me i përcjellë, këto duhet me i pas raporti, jo vetëm në formë tekstuale kemi përcjellë këtë apo atë, por cili është rezultati, sa është numri i OJQ-ve në komunën tonë

që udhëhiqet prej femrave apo që ka punësuar femra, sa përfitojnë ato, këto neve na interesojnë, këtu shihet ai parametri i saktë a janë bërë hapa përpara apo nuk janë bërë, në bazë të kësaj ne nuk mundemi me ditë. Ekziston një Zyre për Barazi Gjinore që po e marr shembull këtë zyrë që vlen për të gjitha resurset edhe të dhëna konkrete nuk ka, vetëm forma tekstuale si roman, kemi përcjellë, shpresojmë se është bërë mirë, është bërë mirë por çka është ajo që është bërë mirë konkretisht me shifra, raporti duhet të ketë të dhënat e sakta, kjo është vërejtja ime, të dhënat që duhet me pas, është realizuar sa është realizuar dhe anasjelltas, të tjerat do t'i shqyrtojmë sigurisht në mbledhjen e ardhshme. Faleminderit!

Fatmir Iska – Unë pajtohem me doktorin mirëpo ne kemi bërë punë të madhe për këtë raport për këto katër periudha tre mujore, ideja ishte që me përfshi gjithë vitin në çdo drejtori pastaj u dakorduar që me nda në katër periudha si ne tre mujorin parë, te dytë, te tretë dhe të katërt, pastaj doktori thotë që prapë lidhet me raportin ose me statistika d.m.th. prapë shembull si ju e morët e unë dua të marr te barazia gjinore OJQ-të ma konkretisht, prapë është ajo statistikë pra sa femra udhëheqin me OJQ ose me organizata tjera d.m.th. në raport përfshihen punët të cilat janë kryer, unë pajtohem edhe me disa punë që nuk janë kryer kryesisht janë ato te investimet kapitale, ne të gjithë e dimë kur lidhemi me këtë dalim edhe tek bartja e mjeteve, krejt aty shihen nëse diçka nuk është realizuar p.sh. një punë tek investimet kapitale që është llogaritur ndërtimi i semaforëve të ri nuk është bërë, operatori nuk është kanë në gjendje me na furnizua d.m.th. prapë vazhdohet si kod mirëpo priset kontrata me atë operatorë pra nuk ishte në gjendje me na siguruar d.m.th. figurohet ajo si raport por jo mos punë e dikujt d.m.th. këtu kemi statistika, te dhëna, aktivitete te rëndësishme edhe nuk janë përfshirë të gjitha aktivitetet të cilat janë bërë, unë prapë e potencova edhe më herët, raporti është shumë më voluminoz se sa që është prezantuar për ju d.m.th. anëtarëve të KPF-së por edhe anëtarëve të Kuvendit, unë tani nuk dua të zgjatem me tepër se ka edhe shumë, edhe unë pajtohem me ju që mund të ketë të meta mirëpo ky raport nuk votohet, diskutohet, me dhënë kontributin gjithë secili në mënyrë që me përmirësua shërbimet për më tutje gjithnjë në interes të qytetarëve të komunës tonë. Te Florida, bursat në vitin 2019 i kishim 95, në vitin 2018 i kishim 63 pra e kemi rritë dhe unë po lidhem me vlerën por edhe numrin e bursistëve, ne vitin 2018 vlera ose buxheti ka qenë 31,500 euro ndërsa ne vitin 2019 është rritë numri i bursistëve e gjithashtu edhe vlera d.m.th. ne vitin 2019 kemi 42,750 euro pra kemi një ngritje diku rreth 11,000 euro afërsisht te bursat pra është rrit numri i bursistëve por edhe vlera kuptohet. Për një bursist shuma e bursës është 450 euro, në vitin 2018 ka qenë 500 euro pastaj është zbritë pak vlera edhe është rritë edhe shuma d.m.th. kemi afërsisht 11,000 euro ndonëse brenda këtij viti do të shpallet edhe ai konkursi për bursist, shpresoj që me i afrua numrin e 100 bursistëve gjithnjë mos me harrua këtu nëse nuk gaboj janë edhe 12 bursist tjerë ne bashkëpunim me bizneset që i kemi dalë në ndihme studenteve tanë do të thotë vet bizneset tona kanë qenë të gatshme që bashkërisht me neve pa asnjë lloj marrëveshje mirëpo në këto takime individuale pra biseda që kishim kemi edhe 12 bursa tjera të financuara prej bizneseve të komunës tonë. Faleminderit.

Rasim Fazliu – Faleminderit nënkryetar për raportin vjetor që na ke sjellë, unë me gjerësisht për këtë sigurisht që do të flas në mbledhje të kuvendit por desha me cekë i mungojnë disa fjalë e njëra nder to do të ishte që u deshtë me cekë që në vitin që posa e lamë nuk është miratuar buxheti pra është dashtë me cekë se nuk kemi mundur me miratua buxhetin për arsye të caktuara pastaj kemi shembull siç e përmendi doktori me i vënë edhe ato çka nuk kemi mundur me i realizua p.sh. reparti i hemodializes nuk është funksionalizuar e ne e dimë se ka sfida e shumë gjëra tjera por ne e dimë që veç në 2017 objekti ka qenë i gatshëm e tani për këto tjerat veç ju e keni marrë qeverisjen për ta vazhduar më tutje dhe me punua diçka pasi në qoftë se e leni ashtu si ka qenë atëherë çka u morë veshë ajo punë pastaj kemi pasur njëfarë plani që komuna me marr edhe për menaxhimin e mbeturinave në përgjegjësinë e saj që me i rritë të ardhurat komunale pra edhe ne atë drejtim kurrëgj hiq nuk keni bërë pra ka shumë pika të cilat nuk janë prekur e që i mungojnë këtij raporti. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë z. Fazliu për kontributin tuaj, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Plani i Punës së Kryetarit të Komunës dhe qeverisë Komunale për vitin 2020.

Fatmir Iska – Faleminderit kryesues, gjithashtu edhe plani ka përafërsisht përmbajtje të njëjtë sikurse edhe raporti, janë paraqitur prioritetet kryesore për vitin 2020, synimet pastaj edhe aktivitetet e rëndësishme sipas drejtorive dhe të Zyrës së Kryetarit pa i cekur se cilat janë që të mos stërgjatën më tepër d.m.th. nga plani i punës pastaj vjen deri te ajo çka prodhon raportin e punës për vitin 2020. Faleminderit!

Fahrie Lushi – Faleminderit, unë kisha vetëm një kontribut të vogël edhe në këtë pikë. Te drejtoria e Arsimit janë pasqyruar në rregull të gjitha prioritetet dhe gjitha sfidat me të cilat do të ballafaqohet, që nuk janë përfunduar, pastaj ato që kanë për tu vazhduar, mirëpo me bën përshtypje kjo ngritja e cilësisë në arsim, sikurse te plani, edhe te raporti i 2019, po ashtu është edhe në vitin 2020 si plan ngritja e cilësisë në arsim. A ka nga ana e drejtorit ndonjë strategji të re apo ndonjë iniciative e cila përpos kësaj që i mbështesim studentet me bursa që shkojmë e rrisim edhe numrin edhe shifrën, thjesht a ka ndonjë ide apo projekt të ri i cili do të ndihmonte dhe do të funksionalizonte edhe më tepër ngritjen e cilësisë në arsim? Madje është edhe një kritikë nga ana ime apo edhe e shumë të rinjve tjerë që nga rekomandimi që ka marr drejtoria e arsimit për mos hapjen e konkurseve të reja por plotësimin e normave nga ata që janë aty d.m.th. mësimdhënësit që janë, unë mendoj se këtu duhet patjetër drejtoria e arsimit të bëjë disa ndryshime pasi është edhe detyrë e tyre të bëjë disa ndryshime por që të hapen konkurse të reja dhe të mos i demotivojmë të rinjtë sepse nuk e ngrisin cilësinë në arsim me mësimdhënësit të cilët ndoshta edhe nuk dua t'i fyej por që edhe këta të rinjtë meritojnë të jenë pjesë e mësimdhënies që ndoshta me këto metoda të reja do të jepnin kontributin patjetër në arsim. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë znj. Lushi për kontributin tuaj, atëherë pasi nuk kemi tjetër të lajmëruar, konstatojmë se kalon për Kuvend pika e shtatë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i vendimit për dhënie e pëlqimit për këmbimin e pronës komunale për pronë private.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, te nderuar drejtorë, anëtarë të KPF-së, para jush keni propozimin për këmbimin e pronës private me pronë publike, ka të bëjë me zonën kadastrale në Xërxë pra bëhet fjalë me të njëjtën parcelë që kemi biseduar në muajin e kaluar që kemi shpallur fillimisht zonë me interes të përgjithshëm ashtu është kërkuar me ligjin për këmbimin e pronës, bëhet fjalë për sipërfaqe, parcelat në pronësi private me numër 550/2 në bashkë posedim të pronareve Sinani, këmbelhet me parcelën publike në sipërfaqe të përgjithshme prej 263m², prej kësaj sipërfaqe i merret pjesa e parcelës prej 101.91m², kjo aktualisht faktikisht në terren rruga është e kubëzuar që është kryer para disa viteve mirëpo për shkak se ka pasur telashe pronari privat i kësaj parcele me komunitetin që aty jeton dhe ka kërkuar vazhdimisht prej neve që të njëjtën ta rirregullojmë. Qëllimi i këtij këmbimi është ri rregullimi i kësaj hapësire dhe këmbimi me pronë publike me të njëjtën sipërfaqe që ka të bëjë me 191m². Ftoj kuvendarët që pas shqyrtimit të aprovojnë propozim vendimin për këmbim. Faleminderit!

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor, atëherë nëse nuk ka diçka rreth kësaj pike, konstatojmë se kalon për Kuvend pika e tetë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i raportit të punës të Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2019 – Për momentin nuk i shoh askënd nga Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe në sallën e Kuvendit. Faleminderit shumë për kontributin, konstatojmë se kalon për Kuvend edhe pika e nëntë e rendit të ditës. Tani para se me dal te pika, në të ndryshme, jemi në pikën shtesë të cilën e aprovuam e për këtë pikë ftoj drejtorin e Gjeodezisë dhe Kadastrës.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, behet fjalë për 3 parcela në zonën kadastrale në Rahovec, behet fjalë për parcelën me numër 1315/0, 1318/1, 1318/2 d.m.th. bëhet fjalë për parcelën ku kanë qenë ish zyrat e Podrimës, ngjitet me parcelën që është tarraca e Hotel Park Plazës dhe me parcelën ku është faktikisht ndërtesa e hotel Park Plazës. Qëllimi i shpalljes me interes të përgjithshëm të këtyre parcelave që janë pronë publike të komunës së Rahovecit është se na jemi në procedurë për projektimin e sheshit qendror të Rahovecit. Kompania që na kemi memorandum mirëkuptimi Unhabitati ka kërkuar prej neve që fillimisht këto parcela që i përfshin ky shesh duhet të jenë të shpallura zona me interes të përgjithshëm pastaj i vazhdojmë me procedura tjera siç është hapja e konkursit ndërkombëtar për këtë shesh. Ftojë anëtarët e KPF-së që pas shqyrtimit të miratojnë propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm. Faleminderit!

Fehmi Cena – Unë dua vetëm një sqarim, drejtori i prezantoi vetëm 3 parcela, kjo parcela e parë që po thotë 1315/0 që ceket aty Ravan-Ravan, sa e di unë sheshi qendror i qytetit do të ndërtohet në qendër të qytetit e kjo pjesa Ravan është në periferi, po kërkoj një sqarim se çka është në pyetje tash, a është kjo pjesë që do t'i bashkëngjitet këtij sheshi a është në një vend sepse ky vend është më larg se sa aty ku pretendohet qendra kryesore e sheshit. Faleminderit!


Afrim Oruqi – Parcela 1315/0 ka të bëjë fizikisht ku është objekti i hotel Park Plazës d.m.th. ajo pjesa në mes, pastaj ngjitet aty është fusha e sportit 1318/1 ku janë kon ish zyrat e ndërmarrjes shoqërore Podrima edhe 1318/2 është aktualisht ku zhvillon veprimtarinë Hotel Park Plaza, d.m.th. janë 3 parcela në kufijtë njëra me tjetrën të hotel Park Plaza. Faleminderit!

Kryesuesi – Gjithsesi faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë meqë nuk kemi të tjerë të lajmëruar për diskutim, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e nëntë. Të nderuar anëtarë të KPF-së, kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës: **10. Të ndryshme** – nëse ka dikush diçka ,nëse jo atëherë është kërkuar në mbledhjen e fundit ka qenë kërkesë e asamblistit Rexhep Oruqi që në mbledhje të na vjen komandanti i Policisë si raport i Policisë për vitin 2019 dhe të na jep disa sqarime me të hollësishme. Ndoshta është mirë që për mbledhje të jetë prezent edhe komandanti i Policisë. Faleminderit shume anëtarë të KPF-së për kontributin tuaj. Mirupafshim në mbledhjet e ardhshme.

Mbledhja përfundoj 11:45

Rahovec, 21.01.2020

Procesmbajtësi:


Agim Hoti

